

# ÇKA ËSHTË BRUTO PRODUKTI VENDOR?



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO




# ÇKA ËSHTË BRUTO PRODUKTI VENDOR?

Në ekonomitë e vendeve të ndryshme prodhohen miliona produkte dhe ofrohen shërbime të ndryshme. Prodhohen kompjuterë, makina, rroba, ushqime apo ofrohen shërbime si transporti, vizita mjekësore, komunikimet, etj.

**A e keni menduar ndonjëherë sa është vlera totale e të gjitha këtyre të mirave dhe shërbimeve dhe si llogaritet kjo vlerë?**

Një mënyrë shumë e mirë për të matur këtë është Bruto Produkti Vendor (BPV) apo në gjuhën angleze Gross Domestic Product (GDP).



# PO ÇKA NË TË VËRTETË PARAQET BPV DHE SI MATET EKONOMIA ME BPV?!?

BPV – Bruto Produkti Vendor është vlera e të gjitha produkteve dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në ekonominë e një vendi gjatë një periudhe specifike. BPV-ja na mundëson që të vlerësojmë madhësinë dhe normën e rritjes së ekonomisë të një vendi dhe të dijme nëse ekonomia e këtij vendi është e shëndetshme apo jo.

BPV-ja mund të matet me qasje të ndryshme por ajo më e përdorura është qasja e shpenzimeve, e cila ka këtë formulë:



\*Net eksporti= (Eksporti – Importi)

# BPV= Konsumi + Investimet + Shpenzimet Qeveritare + Net eksporti (Eksporti - Importi).



Konsumi



Investimet



Shpenzimet Qeveritare



Net eksporti

## Komponentat e BPV-së

# KONSUMI

Konsumi paraqet shpenzimet e konsumatorëve, pra gjërat që ne blejmë për çdo ditë si ushqimet, rrobat, transporti.



# INVESTIMET

Pjesë tjetër e formulës së BPV-së janë Investimet- që paraqesin blerjen e mallrave kapitale nga ndërmarrjet si: pasuri të reja të paluajtshe komerciale (ndërtesa, fabrika, dyqane), paisje të biznesit, ndërtimin e banesave të reja rezidenciale dhe inventarin. Gjithashtu përfshin edhe investimet e ekonomive familjare siç ëshë blerja e një shtëpie të re.



# SHPENZIMET QEVERTARE

Shpenzimet qeveritare- janë shpenzimet që qeveria i bën për të ofruar shërbimet në sektorin publik si shëndetësi, edukim, mbrojtje, ndërtimin e rrugëve, etj.



# NET EKSPORTI (EKSPORTI – IMPORTI)







Net eksporti (Eksporti – Importi) paraqet mallrat dhe shërbimet e hyra dhe të dala nga një vend.

Psh: Mallrat e prodhuara në vendin tonë që shiten në vendet e tjera, minus mallrat e prodhuara në vendet tjera dhe që shiten në vendin tonë. Pra të gjitha mallrat dhe shërbimet e importuara nga një shtet tjetër nuk përfshihen në BPV.





Nëse ke blerë 1 litër qumësht të importuar nga Sllovenia, kjo nuk përfshihet në BPV-në e Kosovës por përfshihet në BPV-në e Sllovenisë. Ndërsa nëse një shishe verë e prodhuar në Kosovë shitet në Slloveni, kjo do të kalkulohet në BPV-në e Kosovës. Gjithashtu nëse një shishe verë e prodhuar në Kosovë, konsumohet në Kosovë, kjo do të shtohet në BPV-në e Kosovës.

	<b>Prodhuar</b>	<b>Shitur</b>	<b>Përfshihet</b>	
	Slloveni	Kosovë	 <b>BPV e Sllovenisë</b>	
	Kosovë	Slloveni	 <b>BPV e Kosovës</b>	



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

**Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,**

**Prishtinë, Kosovë**

**[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)**

**E-mail: [info@bqk-kos.org](mailto:info@bqk-kos.org)**

**Telefon: +383 38 222 055**

**Fax: +383 38 243 763**